



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2025

VENDIM
Nr. 510, datë 29.07.2025

PËR
TRANSFERIMIN E GJYQTARES {...}, NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË, NË NJË POZICION TË
LIRË NË FUSHËN E SË DREJTËS CIVILE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 4 dhe 147/1/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 dhe 89 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 42 dhe 44/2B të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, referuar Vendimit nr. 485, datë 28.07.2025 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi shqyrtoi zgjedhjen për tu transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e të njëjtit nivel, të gjyqtares znj. {...} datë 28.07.2025, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Transferimin e gjyqtares znj. {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në fushën e së drejtës civile, për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ku është caktuar në mënyrë të përhershme.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR